



BASHKIA  
TIRANË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË  
TIRANA PARKING



## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: **BOE “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” sh.p.k** me Nr.Nipti: **K8223002K& “SI.SI-AL”sh.p.k** me Nr.Nipti: **K72117030P**, Adresë: Tepelene, Rruga Tepelene-Progonat, Vendodhje Skaranë dhe Tiranë Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, km 4, Përballë Bmw-së.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, prokurim me mjete elektronike – Punë me numër **REF-15007-12-14-2021**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Plotësimi me Sinjalistik i Rrugëve me Tarifim”**

**Fondi limit 2,218,141** (dy milion e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e një) **lekë pa TVSH**

Burimi i Financimit: vënë në dispozicion nga Buxheti i Tirana Parking, miratuar me V.K.B. Nr.172 datë 21.12.2020 të Këshillit Bashkiak të Tiranës “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2021”

**Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 4** (katër) muaj duke nisur nga data e lidhjes së kontratës

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **06/01/2022, ora 11:00**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

**Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në këtë procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

**1.Operatori ekonomik “R. S. & M” sh.p.k**

**K32203002I**

Çmimi total i ofertës është **2,204,980** (dy milion e dyqind e katër mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) **Lekë pa TVSH**

**2. Operatori ekonomik:**

*numri i NIPT-it*

**BOE “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” & “SI.SI-AL”sh.p.k**

**K82230002K & K72117030P**

Çmimi total i ofertës është **2,191,400** (dy milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind) **Lekë pa TVSH**

### **1. Shqyrtohet oferta e paraqitur nga ofertuesi “R. S. & M” sh.p.k**

Çmimi total i ofertës është **2,204,980** (dy milion e dyqind e katër mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) **Lekë pa TVSH**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjor dhe teknik të ofertës së ofertuar në këtë procedurë prokurimi rezulton se:

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- Nuk i plotëson kriteret e veçanta të përcaktuara në DST. Është paraqitur grafiku i lëvrimit sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat e tenderit.
- Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” kreu X neni 82, pika 3, Komisioni konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Operatori ekonomik “**R. S. & M**” sh.p.k në datën dhe orën e përcaktuar si afati i fundit për dorezimin dhe pranimin e mostrave : datë 06.01.2022 në orën 11.00 **nuk** ka paraqitur asnjë nga mostrat e kërkuara sipas pikës **2.4.2** Shtojca 7, Kriteret e veçanta të kualifikimit të DST-ve (Dokumentave Standarte të Tenderit) ku citohet:

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë në orën e përcaktuar për hapjen e ofertave, pranë Tirana Parking, mostrat në ambalazhim origjinal, nëpërmjet të cilave do të bëhet verifikimi i produktit, si më poshtë:*

- *Bojë akrelike e Bardhë*
- *Bojë akrelike e Zezë*
- *Bojë akrelike e Verdhë*
- *Bojë akrelike Blu*
- *Tabelë 60x90 (Parkim me pagese 60x90cm)*
- *Tabelë 60x20 (SMS Pay 60x90cm)*
- *Tabelë 60x60(P 60x60cm)*
- *Tabelë 60x40(Table Taksi)*
- *Tabelë 60x20 (Paneli Vendeve Taxi)*
- *Tabelë 60x90 (Inv-U 60x90cm)*
- *Tabelë 60x20( Karraotrec 60x20cm)*
- *Birila lavjerës*

*Mosparaqitja e mostrave, sipas standarteve të specifikimeve teknike, përbën shkak për skualifikim.*

Gjithashtu nuk ka plotësuar dhe Pikën **2.4.3** Shtojca 7, Kriteret e veçanta të kualifikimit të DST-ve (Dokumentave Standarte të Tenderit)

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë për bojrat, fosforin, adezivin dhe tabelat, katalogun dhe/ose skedat teknike të botuara nën autoritetin e prodhuesit, që nënkupton se duhet të jenë me logon e tij dhe ku jepen të gjitha karakteristikat teknike të këtyre materialeve me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.*

**Për sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave** nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92, pika 3 Kreu XI të Ligjit 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 dt 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu X, Neni 82, pika 2, e shpall **të pavlefshme** ofertën e operatorit ekonomik **“R. S. & M” sh.p.k** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit

**2.**Shqyrtohet oferta e paraqitur nga ofertuesi **BOE “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” sh.p.k & “SISI-AL”sh.p.k**

Çmimi total i ofertës është **2,191,400** (dy milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind) **Lekë pa TVSH**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi hapi shpalljet e ofertave, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin si më poshtë:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjor dhe teknik të ofertës së ofertuar në këtë procedurë prokurimi rezulton se:

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- I plotëson kriteret e vecanta të përcaktuara në DST. Është paraqitur grafiku i lëvrimin sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat e tenderit.
- Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” kreu X neni 82, pika 3, Komisioni konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” kreu X neni 82, pika 3, Komisioni konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92, Kreu XI të Ligjit 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik **BOE “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” sh.p.k & “SISI-AL”sh.p.k është në përputhje** me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar **si ofertë të vlefshme**.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 93, Kreu XI të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” , VKM Nr.285 dt 19.05.2021 Kreu X, Neni 82, pika 4“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” vlerëson në bazë të formulës së parashikuar në dokumentat e tenderit nëse oferta është apo jo anomalisht e ulët.

Oferta do të cilësohet anomalisht e ulët sipas përcaktimit të bërë në VKM Nr.285 dt 19.05.2021 Kreu X, Neni 82, pika 4 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Nga shqyrtimi që ju është bërë dokumentacionit të operatorit ekonomik të paraqitur rezultoi fitues nga **1(një)** operator ekonomik dhe rrjedhimisht përdoret formula e mëposhtme:

*“Në rastin kur janë të vlefshme **dy ose më pak** oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlogaritur.”*

**Operatori ekonomik BOE “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” sh.p.k & “SISI-AL”sh.p.k**

Ka paraqitur ofertë ekonomike në shumën prej **2,191,400** (dy milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind) **Lekë pa TVSH**

**Fondi limit** = është **2,218,141** (dy milion e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e një) **lekë pa TVSH**

**BOE “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” sh.p.k & “SI.SI-AL”sh.p.k** me ofertë ekonomike prej **2,191,400** (dy milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind) **Lekë pa TVSH**

**75% i Fondit Limit =75% x 2,218,141 = 1,663,606** (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e gjashtë) **Lekë pa TVSH.**

Nga krahasimi dhe formula e përdorur rezulton se oferta e **BOE“ERAL CONSTRUCTION COMPANY”sh.p.k & “SI.SI-AL”sh.p.k** nuk është anomalisht e ulët.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit të hollësishëm të veprimeve të kryera, gjatë procedurës së prokurimit, duke u ballafaquar me dokumentat e tenderit, si dhe detyrimet ligjore për prokurimet publike, është arritur në konkluzionin, se oferta e paraqitur dhe e dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik nga operatori ekonomik, është e pranueshme dhe e vlefshme të kualifikohet, mbasi është në përputhje me kërkesat e ligjit të prokurimeve, plotëson kërkesat administrativo-ligjore dhe specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit të Autoritetit tonë Kontraktor.

**Nga krahasimi dhe formula e përdorur rezultoi se oferta e paraqitur e vlefshme nuk është anomalisht e ulët** në bazë të nenit 93, Kreu XI të Ligjit nr.162, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”

**Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në përputhje më kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, vendosi të bëjë vlerësimin dhe klasifikimin e ofertës të vlefshme të shoqërisë, si më poshtë:**

- Operatori ekonomik **BOE“ERAL CONSTRUCTION COMPANY”sh.p.k & “SI.SI-AL”sh.p.k** me ofertë ekonomike në shumën **2,191,400** (dy milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind) **Lekë pa TVSH, kualifikohet** dhe për këtë arsye Komisioni i Vlerësimit të Ofertave **e ka shpallur atë si operatori fitues i procedurës së prokurimit.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se oferta e Operatorit Ekonomik **BOE “ERAL CONSTRUCTION COMPANY”sh.p.k & “SI.SI-AL”sh.p.k** me adresë Tepelene, Rruga Tepelene- Progonat, Vendodhje Skaranë dhe Tiranë Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, km 4, Përballë Bmw-së., me vlerë **2,191,400** (dy milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind) është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”